



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT TIRANË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM

RAPORT VJETOR

MBI ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM TIRANË
PËR VITIN 2023

- Objekti : Raportim mbi treguesit kryesorë të punës dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera ligjore të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për vitin 2023.
- Raportuesi : Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- Baza ligjore : Neni 50/2 i ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.
- Drejtuar : Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë,
Z. Olsian Çela

T I R A N Ë

I nderuar z.Prokuror i Përgjithshëm.

Bazuar në parashikimet e nenit 50/2, të ligjit nr.96/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Ju paraqesim këtë raport analitik dhe krahasues mbi

treguesit kryesorë të punës së kryer gjatë vitit 2023 nga personeli i kësaj zyre, si në përfaqësimin e akuzës në çështjet penale objekt shqyrtimi gjyqësor në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ashtu dhe në zbatimin e detyrimeve të tjera të parashikuara në ligj dhe aktet nënligjorë, përmbushjen e objektivave vjetorë referuar planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dhe Rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 si dhe objektivat për të ardhmen.

Në brendësi të raportit paraqiten gjithashtu edhe të dhëna në formë grafike dhe tabelare mbi të gjitha çështjet e përfaqësura në gjykatë, çështje për të cilat ka përfunduar gjykimi.

Në këtë raport vjetor përshkruhet veprimtaria e plotë dhe organizimi i Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si Prokuroria e vetme e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë, e cila filloi funksionimin në datën 01.02.2023, me ndërprerjen e veprimtarisë dhe pushimin së ekzistuari të Gjykatave të Apelit Shkodër, Durrës, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë në datën 31.01.2023.

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë (e riemërtuar me urdhrin nr.9, date 18.1.2023) vazhdoi funksionimin pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me kompetenca tokësore në gjithë territorin e vendit.

Në lidhje me ecurinë e mbartjes së akteve procedurale dhe administrative, në përputhje me udhëzimin nr.1 datë 21.01.2023 të Prokurorit të Përgjithshëm, Ju informojmë se ky proces u realizua dhe përfundoi në kohë, si për sa i përket akteve procedurale, pra akteve që përmbanin çështjet penale të arkivuara dhe ato të mbartura në shqyrtim gjyqësor, ashtu dhe ato administrative, pa hasur problematika.

Në asnjë rast nuk pati problematika në lidhje me përfaqësimin në gjykim të çështjeve të mbartuara më parë nga ish Prokuroritë e Apeleve.

Vlen të përmendet se është përballuar një volum shumë i madh pune me një numër të reduktuar prokurorësh.

Në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në datën 1 Shkurt 2023 e kanë ushtruar detyrën efektivisht 12 prokurorë, të cilët kanë kompetencën territoriale mbi gjithë Republikën e Shqipërisë për çështjet penale.

Më pas, për shkak të shkarkimit të Prokurorit Kujtim Basha, përfundimit të komandimit të Prokurores Pranvera Gruda dhe emërimit si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Prokurorit Moisi Duda, efektivisht, ushtrojnë detyrën 9 prokurorë.

Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm vazhdon ta ushtroj aktivitetin në të njëjtën godinë që ka patur Prokuroria e Apelit Tiranë, në godinën 4 katëshe (në të cilin janë të akomoduar prokurorët dhe stafi administrativ).

Prokurorët që ushtrojnë funksionin janë të akomoduar në zyra më vete, dhe stafi administrativ në ambientet e tjera të godinës.

Sqarojmë këtu se godina plotëson kushtet e një prokurorie me standardet e nevojshme, dhe jemi përpjekur të krijojmë kushtet dhe të marrim të gjitha masat për të mundësuar zhvillimin normal të veprimtarisë dhe krijimin e një ambjenti të sigurt, si për prokurorët ashtu edhe për stafin administrativ.

Referuar të dhënave të marra nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, rezultoi se në datën 01.02.2023, numëri total i çështjeve gjyqësore të natyrës penale që u evidentuan ishte **9845**. Këto çështje ishin në pritje të planifikimit për gjykim.

Po referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga ana e gjykatës, rezultoi se nga data 01 Shkurt 2023- 31 Dhjetor 2023 janë regjistruar edhe **6654** çështje të reja të natyrës penale.

Nga Gjykata e Lartë, për vitin 2023, janë kthyer për rigjykim 118 penale, të cilat janë regjistruar dhe janë shortuar.

Këto të dhëna përbëjnë dhe ngarkesën reale që është evidentuar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për vitin kalendarik 2023.

Për të patur sukses është shumë i rëndësishëm organizimi i punës, ku janë marrë masa që shpërndarja e punës të bëhet në funksion të përfaqësimit dinjitoz në gjyq.

Kështu për masat e sigurimit është përdorur sistemi i prokurorëve të gatshëm, me grafikë mujor, duke ruajtur sistemin e radhës sipas grafikut.

Duke qënë se nga ana e Gjykatës, lista e gadishmërisë u planifikua me tre gjyqtarë të gatshëm në javë, kjo e detyruar dhe nga numri i konsiderueshëm i çështjeve penale me objekt ankimet ndaj vendimarrjes së Gjykatës për masa sigurimi, dhe organi i akuzës ju përshtat kësaj skeme, duke planifikuar tre prokurorë të gatshëm në javë.

Kjo mënyrë organizimi ka qënë e domosdoshme për të bërë të mundur që përfaqësimi të realizohet në orën e datën e caktuar për gjykim dhe nuk ka as dhe një rast që çështja të mos jetë zhvilluar për shkak të mungesës së prokurorit.

Nga ana tjetër, duke qënë se numri total i prokurorëve është 9, rezulton se për shkak të kësaj skeme gatishmërie, përfaqësimi në çështje e tjera të planifikuara që të zhvillohen në gjykatë gjatë kësaj periudhe, të ketë dhe raste që të shtyhen për shkak të pamundësisë fizike të prezencës së prokurorit.

Megjithatë nga ana jonë janë bërë përpjekjet maksimale që këto raste të minimizohen.

Për çështjet e themelit, nga ana ime si drejtues është treguar kujdes që trajtimi dhe ndarja e çështjeve midis prokurorëve të jetë e barabartë, jo vetëm duke u nisur nga numri, por

edhe nga shkalla e rrezikshmërisë dhe e rëndësisë së çështjes, numrit të pandehurve, ndarje në mënyrë të barabartë të çështjeve që gjykohen në apel mbi bazën e ankimeve të prokurorëve dhe ankimeve të bëra nga ana e palëve të tjera në procesin penal.

Ndërkohë, për shkak të numrit të konsiderueshëm të çështjeve, dhe përparësisë që kanë çështjet me të pandehur me masa sigurimi “Arrest në burg”, planifikimi i tyre prej gjyqtarëve, bëhet jo në mënyrë periodike (*praktika ka qënë që çështjet e themelit na viheshin në dispozicion për tu studiuar të paktën 1 muaj para fillimit të gjykimit*) por sipas ngutshmërisë që ka çështja, duke patur një kohë relative në dispozicion për studimin e çështjes.

Nga ana tjetër dua të sjell në vëmendje se gjatë vitit 2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë zhvilluar gjithsej **7537 seanca gjyqësore për çështje penale**.

Ky aspekt ka një rëndësi të veçantë në funksionimin e organit, sidomos duke patur në konsideratë që Prokuroria dhe Gjykata funksionojnë në godina të veçanta, ç’ka bën që një pjesë e kohës efektive të prokurorëve të konsumohet në pritje të sencave të rradhës, si dhe nga ana e sekretarisë sonë kërkohet të realizohet një punë voluminoze për fotokopjimin në kohë të dosjeve gjyqësore (*masa sigurimi dhe themeli*) për tju vënë në dispozicion prokurorëve për të mundësuar përfaqësimin, plus kryerjen e detyrave të tjera funksionale.

Për sa i përket të dhënave analitike të detajuara dhe të analizuara më lart, duhet thënë se ato përfaqësojnë çështjet penale për të cilat ka përfunduar gjykimi, pra ato që gjyqtarët kanë nxjerrë për shqyrtim gjyqësor e që janë përfunduar gjatë vitit 2023 por jo dhe ato që janë në ngarkim të prokurorëve e për të cilat vazhdon gjykimi.

Pikërisht duke u nisur dhe nga kjo situatë, të dhënat analitike si për ankimet e paraqitura nga Prokuroritë e Rretheve, situata e çështjeve referuar veprave penale konkrete, që po Ju pasqyrojmë në këtë raport, përbëjnë thjesht gjënë e gjykuar por jo atë që është në pritje të gjykohej.

1. ANALIZA E TREGUESVE TË VOLUMIT TË PUNËS.

Treguesit e volumit të përgjithshëm të punës, të kryer nga prokurorët për vitin 2023, përfshijnë të dhënat për sa më poshtë vijon :

1.1 Në total gjatë vitit 2023, nga prokurorët e Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është përfaqësuar akuza në çështjet në gjykim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për 4389 çështje nga të cilat :

- 1345 kanë patur si objekt ankimin ndaj vendimeve të themelit të Gjykatave të Shkallëve të Para, që i përkasin fajësisë, cilësimit juridik të veprave penale, llojit dhe masës dhe alternativave të dënimit), me 1969 të pandehur.
- 665 kanë patur si objekt ankimin ndaj vendimeve të themelit të Gjykatave të Shkallëve të Para, në fazën e hetimeve paraprake, kundërshtim i vendimeve të prokurorit, etj, me 680 persona, të shqyrtuara në dhomë këshillimi.
- 2370 kanë patur si objekt ankimin ndaj vendimeve të themelit të Gjykatave të Shkallëve të Para për llojin e masave të sigurimit dhe vleftësimin e arrestimit në flagrancë/ndalimit, me 3142 persona.

1.2. Duke krahasuar numrin e çështjeve të gjykuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me vitin 2022, ku janë gjykuar gjithsej 1972, numri i çështjeve ka një rritje prej 2417 çështje, e cila është një e dhënë e pritshme, si për shkak të kompetencës territoriale të re të Gjykatës, ashtu dhe për shkak të rritjes së numrit të trupave gjyquese në Kolgjin Penal të Gjykatës.



1.3. Përsa i përket çështjeve **penale në themel** të gjykuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë gjykuar **2010** çështje. Krahasuar me **vitin 2022**, ku janë gjykuar **585 çështje penale në themel**, numri i çështjeve ka një rritje prej **1425** çështje.

1.4 Përsa i përket masave të sigurimit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë gjykuar **2370 masa sigurimi personal**. Krahasuar me **vitin 2022** ku janë **gjykuar 1092** masa sigurimi personal ka një rritje të masave prej **1278** çështje të gjykuara.

1.5. Gjithashtu gjatë vitit 2023, nga Prokurorët e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë kryer detyrimet ligjore në fushën e **ekzekutimit të vendimeve** penale, ku janë **1672** raste të nxjerrjes së urdhërave të ekzekutimit, që lidhen me vendimet me ekzekutim të menjëhershëm të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Numri i urdhërave të ekzekutimit të Prokurorëve të Apelit gjatë vitit 2023, është më i lartë se i atyre të nxjerrë gjatë vitit paraardhës, kur ishin **597** të tillë.

Në këtë aspekt, duhet theksuar së ndjekja e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës, ka patur një proritë, edhe për shkak të faktit se një pjesë e dënimeve të dhëna ishin në prag të përfundimit të tyre, dhe dërgimi i shkurtimeve të vendimeve që na viheshin në dispozicion nga ana e trupave gjyqësore, mundësonte realizimin në kohë të urdhërave të ekzekutimit nga ana e zyrave përkatëse në Prokuroritë e Rretheve.

Mund të sjellim në vëmendje së këtu ka bërë përjashtim, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila ka kthyer mbrapsht disa praktika, me pretendimin se kjo nuk është rruga e duhur ligjore pasi vendimarrja e formës së prerë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Për këtë aspekt, në sajë të involvimit të Nënkryetares së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, po punohet për t'i gjetur një zgjidhje këtij problemi dhe për të parë mundësinë e involvimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm në këtë çështje.

2. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS PËR ÇËSHTJET E THEMELIT.

2.1. Për çështjet e themelit, në total, gjatë vitit 2023 nga prokurorët është përfaqësuar akuza në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për **1345 çështje**, me **1969 të pandehur**, nga të cilët **1348 kanë qenë me masë sigurimi “Arrest në burg”** dhe sipas Rretheve Gjyqësore të dhënat paraqiten sipas rretheve si vijon:

Nr.	Rrethi	Nr.çështje	Të pandehur	Të arrestuar
1	Berat	34	48	29
2	Dibër	29	42	32
3	Durrës	78	121	75
4	Elbasan	49	99	75
5	Fier	66	95	69
6	Gjirokastrë	25	45	32
7	Kavajë	15	20	14
8	Korçë	64	112	82
9	Krujë	65	134	105
10	Kukës	20	30	25
11	Kurbin	32	43	33
12	Lezhë	39	60	40
13	Mat	15	21	15

14	Lushnje	40	64	51
15	Përmet	4	9	9
16	Pogradec	24	35	24
17	Pukë	6	10	9
18	Sarandë	19	24	22
19	Shkodër	59	92	62
20	Tropojë	7	8	5
21	Vlorë	58	79	58
22	Tiranë	597	778	482
	Totali	1345	1969	1348

2.2 Përsa i përket çështjeve të themelit, kanë ardhur dhe janë gjykuar, mbi **apelin e Prokurorit të Shkallës së Parë, 202 çështje** dhe mbi **ankimin e të pandehurve 1143 çështje**.

Nga numri 202 çështje themeli që referuam më lart e që shjeguam që kanë ardhur për gjykim mbi bazën e apelit të Prokurorit të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, nga ana e Prokurorëve të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm,

- Në 134 raste është mbështetur apeli para gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm
- Në 68 hequr dorë nga apeli, ku sipas veprave si vijon:
 - 16 çështje, për nenet 76, 99, 101, 109,110,124, 181,183,186,190, 200, 238, 248, 291, 293, të Kodit Penal (nga 1 çështje për secilën vepër)
 - 6 çështje për nenin 134 të Kodit Penal
 - 2 çështje për nenin 137 të Kodit Penal
 - 3 çështje për nenin 199 të Kodit Penal
 - 5 çështje për nenin 283 të Kodit Penal
 - 2 çështje për nenin 290 të Kodit Penal
 - 34 çështje të tjera

2.3 Ndër çështjet e apeluara, në **212** raste Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur **mospranimin** e ankimeve të pandehurve, pasi çështjet kanë mbetur pa objekt për shkak të kryerjes së dënimit si dhe në disa raste për shkak të mosplotësimit të shkaqeve formale të parashikuara nga ligji procedural (*ankimet e mbrojtësve pa akte të veçantë delegim të drejtë ankimi nga i pandehuri*).

	Rrethi	Çështje te apeluara nga Prokurorët e Shkallës së Parë	SH U		Vleresimi i Prokurorit të Apelit për
--	--------	---	---------	--	--------------------------------------

Anki me 2023		Objekti Ankimit				M A	Ankim i të pandeh urit	ankimin e Prokurorëve të Shkallës së Parë	
		Pafaj si	Pus h. akuz e	Nd. kual if	Mase dënim i			Mbës htetu r Anki m	Hequ r Dore
1	Berat	1	-	-	5	6	28	5	1
2	Dibër	1	-	2	1	4	25	2	2
3	Durrës	-	-	2	8	10	68	6	4
4	Elbasan	2	2		1	5	44	4	1
5	Fier	1	2	2	8	13	53	5	8
6	Gjirokastrë	-	1	-	2	3	22	3	-
7	Kavajë	-	1	-	1	2	13	2	-
8	Korçë	3	-	-		3	61	1	2
9	Krujë	-	-	-	2	2	63	2	-
10	Kukës	1	-	-	2	3	17	3	-
11	Kurbin	-	-	2	8	10	22	6	4
12	Lezhë	1	-	1	5	7	32	4	3
13	Mat	1	-	-	-	1	14	-	1
14	Lushnje	-	-	2	8	10	30	7	3
15	Përmet	-	-	1	-	1	3	1	-
16	Pogradec	2	-	-	1	3	21	-	-
17	Pukë	-	-	-	-	0	6	-	-
18	Sarandë	-	-	-	3	3	16	2	1
19	Shkodër	9	-	2	7	18	41	12	6
20	Tropojë	1	-	-	-	1	6	1	-
21	Vlorë	1	-	1	7	9	49	6	3
22	Tiranë	15	40	8	25	88	509	62	29
	Totali	39	46	23	94	202	1143	134	68

2.4 Në gjykimin e çështjeve të apeluara, në **153** raste kërkesat e **Prokurorit të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm** kanë qenë për ndryshim të vendimit të Shkallës së Parë dhe **rëndim** të pozitës së të pandehurit, për të cilat Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur si vijon :

- 87 çështje e ka **lënë në fuqi** vendimin e Shkallës së Parë.
- 43 çështje e ka ndryshuar vendimin duke **rënduar** pozitën e të pandehurit.

- 15 çështje e ka ndryshuar vendimin duke **lehtësuar** pozitën e të pandehurit, pasi ka patur ankim si nga prokurori ashtu dhe nga i pandehuri.
- 1 rast e ka prishur vendimin dhe ka vendosur pushimin e çështjes.
- 7 çështje e ka prishur vendimin dhe ka kthyer aktet për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë.

2.5 Në gjykimin e çështjeve të apeluara, në **55** raste kërkesat e Prokurorit të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm kanë qenë për ndryshim të vendimit të Shkallës së Parë dhe **lehtësim** të pozitës së të pandehurit, për të cilat Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur si vijon :

- **49** raste nga të cilat janë pranuar kërkesat e organit të akuzës
- **4** raste është lënë në fuqi nga Gjykata,
- **1** rast e ka prishur vendimin dhe ka vendosur pushimin e çështjes,
- **1** rast, prishjen vendimi e kthim të akteve për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë.

2.6 Në **16** raste është kërkuar nga ana jonë **pushimi i** çështjes (rastet e parashkrimit të dënimeve alternative dhe kërkesave për revokimin e tyre) nga të cilat Gjykata në 6 raste nuk e ka pranuar këtë qëndrim tonin dhe ka vendosur lënien në fuqi të vendimit, në 8 raste e ka pranuar arsyetimin tonë dhe ka vendosur prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes dhe në **2** raste ka vendosur prishje vendimi e kthim të akteve për rigjykim.

2.7 Në **24** raste është kërkuar nga ana jonë, **prishje vendimi e kthim të akteve për rigjykim**, nga të cilat në **17** raste është pranuar nga Gjykata dhe 7 raste është lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.

2.8 Në gjykimin e çështjeve të apeluara, në **1097** raste , kërkesat e **Prokurorit të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm** kanë qenë për **lënie në fuqi** të vendimit të Shkallës së Parë, për të cilat Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur si vijon :

- **864** çështje e ka **lënë në fuqi** vendimin
- **190** çështje e ka ndryshuar vendimin, duke **lehtësuar** pozitën e të pandehurit,
- **18** raste e ka prishur vendimin dhe ka **pushuar** çështjen.
- **25** raste e ka prishur vendimin dhe ka kthyer çështjen për **rigjykim**.

2.9 Gjatë vitit 2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm jane gjykuar në dhomë këshillimi edhe **665** çështje, me objekt administrativo penal si më poshtë listuar, me 680 persona, konkretisht

- **221** çështje - Ankim ndaj "vendimit mosfillimit",
- **177** çështje - Ankim ndaj "vendimit pushimit"

- **267** çështje - Kërkesë për ndryshimin e institucionit të vuajtjes së dënimit me burg, kërkesë për bashkim denimi, kërkesë për ulje dënimi, rivendosje në afat etj.

2.10 Gjatë vitit 2023, Prokurorët e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm kanë ushtruar **rekurs** mbi vendimet për **çështjet e themelit** të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në **53** raste.

2.11 Nga çështjet e gjykuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, numrin më të lartë të veprave penale po e paraqesim si më poshtë vijon:

Për veprat penale për gjykime themeli, që i përkasin veprave penale kundër “Dhunës në familje”, nenet 130; 130/a; 130/a/1, 130/a/1/2; 130/a/2/3; 130/a/3; 130/a/4 të K.Penal, të përfundura për periudhën Janar- Dhjetor 2023, janë 170 çështje gjithsej.

Për veprat penale për gjykime themeli, që i përkasin veprave penale “Vrasja” nenet 76,76-22,78, 78/1/25 78/2-22, 79/c, 79/dh-25 të K.Penal të përfundura për periudhën Janar-Dhjetor 2023, janë 47 çështje gjithsej.

Për veprat penale për gjykime themeli, në fushën e “Lëndëve narkotike” nenet 283; 283/1; 283/2; 284; 284/1; 284/2; të K.Penal të përfundura për periudhën Janar- Dhjetor 2023, janë 230 çështje gjithsej.

Për veprat penale për gjykime themeli, në fushën e “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe municionit ” nenet 278; 278/1; 278/2; 278/3; 278/4; 278/5; të K.Penal të përfundura për periudhën Janar-Dhjetor 2023, janë 87 çështje gjithsej.

Për veprat penale për gjykime themeli, që i përkasin veprave penale “Vjedhja” nenet 134;134/1;135/-25/137/1;139;140;141/a-25 143; të K.Penal të përfundura për periudhën Janar- Dhjetor 2023, janë 145 çështje gjithsej.

Në mënyre të detajuar, më poshtë ju paraqesim të dhënat për veprat që si cituar kanë patur numrin më të lartë dhe qëndrimet e prokurorëve dhe të gjykatës ndaj këtyre çështjeve ;

“Dhuna në familje”, nenet 130; 130/a; 130/a/1, 130/a/1/2; 130/a/2/3; 130/a/3; 130/a/4 të K.Penal, të përfundura janë 170 çështje nga te cilat:

- **7** çështje ardhur me ankim të prokurorit të shkallës së parë, (**1 çështje për ndryshim kualifikimi të veprës dhe 6 çështje për pretendim për masë të butë dënimi të dhënë nga gjykata**), nga të cilat :
- ❖ **1** çështje **mbështetur ankimi** i prokurorit të shkallës së parë nga prokurori i apelit

❖ 6 çështje hequr dorë nga ankimi i prokurorit të shkallës së parë.

➤ Nga ky grup veprash, 183 çështje ardhur me ankim të pandehurve nga të cilat:

- 162 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për **lënien në fuqi** të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë, dhe për këtë kërkim, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm **ka vendosur**:
 - 147 çështje për **lënien në fuqi** të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë.
 - 14 çështje për lehtësim të pozitës së të pandehurit
 - 1 çështje prishje vendimi dhe kthim të akteve për rigjykim.
- 1 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për të ndryshuar vendimin duke **rënduar** pozitën e të pandehurit kërkim i pranuar edhe nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (sipas ankimit të prokurorit).
- 6 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për ndryshim vendimi duke **lehtësuar** pozitën e të pandehurit, për këtë kërkim edhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm,ka ndryshuar vendimin duke **lehtësuar** pozitën e të pandehurit
- 1 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për **prishje vendimi dhe kthim për rigjykim** të akteve, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

“Vrasja” nenet 76,76-22,78, 78/1/25 78/2-22, 79/c, 79/dh-25, të K.Penal të përfundura për periudhën Janar- Dhjetor 2023, janë 47 çështje gjithsej.

➤ 11 çështje ardhur me ankim të prokurorit të shkallës së parë (7 çështje për *ndryshim kualifikimi të veprës dhe 4 çështje për pretendim për masë të butë dënimi të dhënë nga gjykata* nga të cilat :

- ❖ 10 çështje **mbështetur ankimi** i prokurorit të shkallës së parë nga prokurori i apelit
- ❖ 1 çështje hequr dorë nga ankimi i prokurorit të shkallës së parë.

➤ 36 çështje ardhur me ankim të pandehurve nga të cilat:

- 35 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për **lënien në fuqi** të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë, dhe për këtë kërkim, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm **ka vendosur**:
 - 19 çështje për **lënien në fuqi** të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë.
 - 15 çështje për lehtësim të pozitës së të pandehurit
 - 2 çështje prishje vendimi dhe kthim të akteve për rigjykim

- 10 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për të ndryshuar vendimin duke **rënduar** pozitën e të pandehurit dhe për këtë kërkim, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm **ka vendosur**:
 - 3 çështje për **lënien në fuqi** të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë.
 - 6 çështje **rënduar** pozitën e të pandehurit (*pranuar ankimin e prokurorit*)
 - 1 çështje për **lehtësim** të pozitës së të pandehurit
- 1 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për ndryshim vendimi duke **lehtësuar** pozitën e të pandehurit, për këtë kërkim Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ka pranuar kërkesën e prokurorit, duke lehtësuar pozitën e të pandehurit.
- 1 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për **prishje vendimi dhe kthim për rigjykim** të akteve, kërkesë e cila është pranuar edhe nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

✚ Për këtë vepër penale prokurorët e apelit kanë ushtruar **Rekurs** pranë Gjykatës së Lartë në 6 raste.

“Lëndët narkotike” nenet 283; 283/1; 283/2; 284; 284/1; 284/2; të K.Penal të përfundura për periudhën Janar- Dhjetor 2023, janë 230 çështje gjithsej.

- 21 çështje ardhur me ankim të **prokurorit** të shkallës së parë (8 çështje për *pafajsi*, 6 çështje për *ndryshim kualifikimi të veprës* dhe 7 çështje për *pretendim për masë të butë dënimi të dhënë nga gjykata* nga të cilat :
 - ❖ 16 çështje **mbështetur ankimi** i prokurorit të shkallës së parë nga prokurori i apelit
 - ❖ 5 çështje hequr dorë nga ankimi i prokurorit të shkallës së parë.
- 209 çështje ardhur me ankim të **pandehurve** nga të cilat:
 - 200 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për **lënien në fuqi** të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë, dhe për këtë kërkim, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm **ka vendosur**:
 - 137 çështje për **lënien në fuqi** të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë.
 - 55 çështje për **lehtësim** të pozitës së të pandehurit
 - 2 çështje prishje vendimi **pushim/pafajësi**
 - 6 çështje prishje vendimi dhe kthim të akteve për **rigjykim**
 - 16 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për të ndryshuar vendimin duke **rënduar** pozitën e të pandehurit dhe për këtë kërkim, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm **ka vendosur**:

-10 çështje për **lënien në fuqi** të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë.

- 3 çështje **rënduar** pozitën e të pandehurit (*pranuar ankimin e prokurorit*)

- 2 çështje për **lehtësim** të pozitës së të pandehurit

- 1 çështje prishje vendimi dhe kthim të akteve **për rigjykim**

- 12 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për ndryshim vendimi duke **lehtësuar** pozitën e të pandehurit, për këtë kërkim Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, **ka vendosur:**

-1 çështje për **lënien në fuqi** të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë.

-10 çështje për **lehtësim** të pozitës së të pandehurit

- 1 çështje prishje vendimi dhe kthim të akteve për **rigjykim**

- 1 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për **prishje vendimi dhe kthim për rigjykim** të akteve, kërkesë e cila është pranuar edhe nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

- 1 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për çështje prishje vendimi **pushim/pafajësi** të akteve, kërkesë e cila është pranuar edhe nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

🚩 Për këtë vepër penale prokurorët e apelit kanë ushtruar **Rekurs** pranë Gjykatës së Lartë në 15 raste.

“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve shpërthyes dhe municionit ” nenet 278; 278/1; 278/2; 278/3; 278/4; 278/5; të K.Penal të përfundura për periudhën Janar-Dhjetor 2023, janë 87 çështje gjithsej.

- 9 çështje ardhur me ankim të **prokurorit** të shkallës së parë (2 çështje për **pafajsi**, 3 çështje për **ndryshim kualifikimi** të veprës dhe 4 çështje për **pretendim për masë të butë dënimi të dhënë nga gjykata** nga të cilat :

- ❖ 9 çështje **mbështetur ankimi** i prokurorit të shkallës së parë nga prokurori i apelit

- 78 çështje ardhur me ankim të **pandehurve** nga të cilat:

- 77 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për **lënien në fuqi** të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë, dhe për këtë kërkim, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm **ka vendosur:**

- 63 çështje për **lënien në fuqi** të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë.

- 14 çështje për **lehtësim** të pozitës së të pandehurit

- 8 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për të ndryshuar vendimin duke **rënduar** pozitën e të pandehurit dhe për këtë kërkim, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm **ka vendosur**:
 - 5 çështje për **lënien në fuqi** të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë.
 - 2 çështje për **lehtësim** të pozitës së të pandehurit
 - 1 çështje prishje vendimi dhe kthim të akteve **për rigjykim**
- 1 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për ndryshim vendimi duke **lehtësuar** pozitën e të pandehurit, për këtë kërkim Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ka pranuar kërkesën e prokurorit, duke lehtësuar pozitën e të pandehurit.
- 1 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për **prishje vendimi dhe kthim për rigjykim** të akteve, kërkesë e cila është pranuar edhe nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

✚ Për këtë vepër penale prokurorët e apelit kanë ushtruar **Rekurs** pranë Gjykatës së Lartë në 4 raste.

“Vjedhja” nenet 134; 134/1; 135/-25/, 137/1; 139; 140; 141/a-25 143; të K.Penal të përfundura për periudhën Janar- Dhjetor 2023, janë **145** çështje gjithsej.

- 12 çështje ardhur me ankim të **prokurorit** të shkallës së parë (6 çështje për ***pafajsi***, 1 çështje pushim akuze, 1 çështje për ***ndryshim kualifikimi të veprës*** dhe 4 çështje për ***pretendim për masë të butë dënimi të dhënë nga gjykata*** nga të cilat :
 - ❖ 8 çështje **mbështetur ankimi** i prokurorit të shkallës së parë nga prokurori i apelit
 - ❖ 4 çështje hequr dorë nga ankimi i prokurorit të shkallës së parë.
- 133 çështje ardhur me ankim të **pandehurve** nga të cilat:
 - 125 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për **lënien në fuqi** të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë, dhe për këtë kërkim, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm **ka vendosur**:
 - 103 çështje për **lënien në fuqi** të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë.
 - 14 çështje për **lehtësim** të pozitës së të pandehurit
 - 5 çështje prishje vendimi **pushim/pafajësi**
 - 3 çështje prishje vendimi dhe kthim të akteve për **rigjykim**

- 10 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për të ndryshuar vendimin duke **rënduar** pozitën e të pandehurit dhe për këtë kërkim, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm **ka vendosur**:
 - 6 çështje për **lënien në fuqi** të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë.
 - 1 çështje **rënduar** pozitën e të pandehurit (*pranuar ankimin e prokurorit*)
 - 3 çështje për **lehtësim** të pozitës së të pandehurit
 - 10 çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për ndryshim vendimi duke **lehtësuar** pozitën e të pandehurit, për këtë kërkim Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, **ka vendosur**:
 - 1 çështje për **lënien në fuqi** të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë
 - 8 çështje për **lehtësim** të pozitës së të pandehurit
 - 1 çështje prishje vendimi **pushim/pafajësi**
- ✚ Për këtë vepër penale prokurorët e apelit kanë ushtruar **Rekurs** pranë Gjykatës së Lartë në 4 raste

2.12 Më poshtë po ju paraqesim në mënyrë të përmblodhur çështjet e përfaqësura nga ana e Prokurorëve të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për të cilat ka përfunduar gjykimi:

PËR ÇËSHTJE THEMELI

Nr.	Prokurori	Çështje gjithsej	Të ardhura mbi apelin e prokurorit	Mbështetur ankimi i prokurorit të Shkallës së Parë	Hequr dorë nga ankimi prokurorit të	Gjithsej ankime të prokurorit të pranuar nga Gjykata	Rekurse të bërë për të gjitha çështjet e përfaqësura.
1	Arben Qosja	158	14	10	4	3	5
2	Arta Marku	130	33	24	9	5	7
3	Aferdita Ndoi	101	13	9	4	3	6
4	Etien Kapo	123	16	9	7	3	1
5	Genti Xholi	138	23	10	13	5	3
6	Gjon Fusha	100	15	12	3	4	6

7	Irma Balli	117	12	10	2	3	3
8	Kujtim Bashaj	71	11	7	4	3	4
9	Kleanth Zeka	120	18	14	4	4	5
10	Lazer Çardaku	112	21	17	4	3	6
11	Moisi Duda	90	12	6	6	5	4
12	Pranvera Gruda	45	8	6	2	2	3
13	Elidiana Kasa	43	6	-	6		
		1345	202	134	68	43	53

2.13 Çështje që kanë të bëjnë me Mardhëniet Juridiksionale me Jashtë.

Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë gjykuar **21** çështje penale me objekt “Lejim Ekstradimi”, nga të cilat:

- 1 çështje me **ankim të prokurorit** të Shkallës së Parë e mbështetur nga Prokurori i Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për të cilën Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur lënien në fuqi të vendimit.
- 1 çështje, kërkesa e Prokurorit të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është për ndryshim vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe **rrezimin e kërkesës** për lejim ekstradimi. Për këtë kërkim edhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka ndryshuar vendimin duke rrëzuar kërkesën për ekstradim.
- 1 çështje, kërkesa e Prokurorit të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është për **prishje vendimi dhe pushim** të çështjes të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, edhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka ndryshuar vendimin duke pushuar çështjen.
- 18 çështje kërkesa e Prokurorit të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është për **lënien në fuqi** të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Për këto raste, për 13 çështje Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur lënien në fuqi të vendimit dhe për 5 çështje ka ndryshuar vendimin e rrëzuar kërkesën për ekstradim, nga të cilat në 3 raste Prokurori i Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë gjykuar **10** çështje penale me objekt “Njohje vendimi panel të huaj”, nga të cilat:

- 4 çështje me **ankim të Prokurorit** të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm e mbështetur nga Prokurori i Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për të cilat edhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në 4 raste ka pranuar ankimin e prokurorit.
- 1 çështje kërkesa e Prokurorit të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është për ndryshim vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe **rrezimin e kërkesës** edhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka ndryshuar vendimin.
- 1 çështje kërkesa e Prokurorit të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është për **prishje vendimi dhe kthim për rigjykim** edhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka ndryshuar vendimin e kthyer për rigjykim.
- 4 çështje kërkesa e Prokurorit të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është për **lënien në fuqi** të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, për të cilat edhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur lënien në fuqi të vendimit.

2.14 Çështje që kanë patur si objekt kërkesat e prokurorisë për dërgimin e çështjes për gjykim, të gjykuara nga Gjyqtari I hetimeve paraprake.

Gjatë vitit 2023, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë gjykuar 21 çështje që kanë patur si objekt kërkesën e prokurorisë për dërgimin e çështjes për gjykim, të gjykuara nga Gjyqtari I hetimeve paraprake.

Nga këto raste,

-13 çështje kanë ardhur me ankim të Prokurorit të Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kundër vendimi të Gjyqtarit të hetimeve paraprake, që ka vendosur për pushim të çështjes.

Nga këto 13 çështje që kanë ardhur me ankim të organit të akuzës, nga ana e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në 8 çështje është mbështetur ankimi i prokurorit të Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe për 5 çështje është hequr dorë nga ankimi.

Për çështjet lartpërmendur, nga 8 çështjet kur është mbështetur ankimi i prokurorit të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në 2 raste ka pranuar ankimin e Prokurorit të Apelit.

Për 8 çështjet që ankimi kundër vendimi të Gjyqtarit të hetimeve paraprake, është bërë nga palët e tjera ndërgjyqëse, prokurorët e Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, kanë kërkuar lënien në fuqi të vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë.

Për këto raste, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur lënien në fuqi të vendimit për 6 çështje dhe ka ndryshuar vendimin vetëm për 2 çështje.

Për sa i përket ankimeve të shqyrtuara gjatë këtij viti, nga ana e trupës së prokurorëve konstatohet se një pjesë e konsiderueshme e ankimeve, u mungon analiza e vendimit të gjykatës së shkallës, cka nënkupton se prokurorët e ushtrojnë këtë të drejtë pa pritur njohjen me vendimin objekt ankimi.

Këto ankimi janë pothuaj të njëjta me konkluzionet e paraqitur në seancë gjyqësore dhe shkaqet e ankimit janë të karakterit të përgjithshëm.

Ky element ka një rëndësi të veçantë, sidomos në dritën e parashikimit të nenit 425 I cili parashikon se gjykata e apelit shqyrton çështjen brenda shkaqeve të ankimit, parashikim ky që respektohet rigorozisht nga trupat penale e passjell dhe problematikë në përfaqësimin e çështjes.

Në këtë këndvështrim, rëndësi ka që dhe në rastet e parashikuara nga neni 427/4 I Kodit të Procedurës Penale, që ka të bëjmë me rastet kur I pandehuri është deklaruar I pafajshëm. Ndryshimi që ka pësuar dispozita normon detyrimin e riçeljes së shqyrtimit gjyqësor për këto raste, dhe po hasen në praktikë pretendime të trupave gjykues që kjo kërkesë, pra ricelja e shqyrtimit gjyqësor duhet të jetë e parashtruar në ankimin e bërë dhe nga prokurori I shkallës së parë, se bashku me kërkesën për ndryshimin e vendimit për deklarimin e pafajshëm, në të cilën të listohen dhe provat që pretendon se duhet ti nënshtrohen rishqyrtimit gjyqësor e që do të passjellin dhe mundësinë e ndryshimit të vendimit

Për të shmangur një problematikë të tillë të mundshme në të ardhmen, mbetet që kjo situatë të jetë në vëmendje të prokurorëve të shkallës së parë.

3 ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS PËR ÇËSHTJET E MASAVE TË SIGURIMIT.

3.1. Në gjykimin e masave të sigurimit, **në total** gjatë vitit **2023** nga prokurorët është përfaqësuar akuza në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për **2370** çështje (vitin paraardhës ishin **1092**), ku sipas Rretheve Gjyqësore të dhënat paraqiten si në vijim;

Nr.	Rrethi	Nr.çështje	Persona nen hetim
1	Berat	80	98
2	Dibër	42	25
3	Durrës	177	279
4	Elbasan	147	245

5	Fier	153	179
6	Gjirokastrë	90	129
7	Kavajë	19	19
8	Korçë	175	247
9	Krujë	37	39
10	Kukës	38	42
11	Kurbin	8	8
12	Lezhë	93	108
13	Mat	9	11
14	Lushnje	12	15
15	Përmet	5	5
16	Pogradec	17	24
17	Pukë	6	8
18	Sarandë	69	92
19	Shkodër	81	135
20	Tropojë	4	5
21	Vlorë	181	267
22	Tiranë	927	1162
	Totali	2370	3142

3.2 Nga ky numër i çështjeve të përfaqësuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për **232** prej tyre **apelues** kanë qenë **Prokuroritë** e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kurse për pjesën tjetër **2138**, apelues kanë qenë personat nën hetim.

3.3 Në tabelën poshtëshënuar pasqyrohet rastet kur palë ankuese ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm për caktimin e masës së sigurimit, ka qenë Prokurori i çështjes, dhe qëndrimi i Prokurorit të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për këto raste si dhe kolona ku pasqyrohen numri i ankimeve të bërë nga pala tjetër, ku sipas rretheve gjyqësorë të dhënat paraqiten si vijon:

Rrethi	Apel Prokurori ndaj vendimeve të Gjykatës			Qëndrimi i Prokurorit të Apelit		Ankim persona nën hetim	Totali
	që ka vendosur masë më të butë	Ka pranuar Zv. e masës	Shuma	Mbështetur Ankimi	Hequr Dore		

Berat	7	1	8	5	3	72	80
Dibër	2	1	3	3	0	39	42
Durrës	10	2	12	9	3	165	177
Elbasan	11	2	13	7	6	134	147
Fier	21	4	25	15	10	128	153
Gjirokastrë	11	2	13	10	3	77	90
Kavajë			0	0	0	19	19
Korçë	12	1	13	7	6	162	175
Krujë	2	5	7	4	3	30	37
Kukës	4	2	6	4	2	32	38
Kurbin		1	1	1	0	7	8
Lezhë	5	6	11	9	2	82	93
Mat	1		1	1	0	8	9
Lushnje			0	0	0	12	12
Përmet	1		1	0	1	4	5
Pogradec	1	1	2	1	1	15	17
Pukë		2	2	2	0	4	6
Sarandë	12	5	17	14	13	52	69
Shkodër	6	1	7	6	1	74	81
Tropojë	1		1	1	0	3	4
Vlorë	21	11	32	29	3	149	181
Tiranë	45	12	57	34	23	870	927
Totali	173	59	232	162	70	2138	2370

3.4 Në **152** raste të **apelimeve** për masat e sigurimit, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur **mospranimin** e tyre (*heqjes dorë nga ankimi prej personave nën hetim/mungesë akti të delegimit të së drejtës së ankimit tek mbrojtësi ligjor*), ndër të cilat, siç shpjeguar më lart, në **70** raste është hequr dorë nga Prokurori i Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

3.5 Grupi i veprave penale për të cilat nga ana e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është hequr dorë nga ankimi

- 18 çështje, për nenet 76, 88, 89, 110, 121, 141, 143, 150, 151, 174, 180, 197, 237, 248, 271, 290, 298, 323 të Kodit Penal (nga 1 çështje për secilën vepër)
- 4 çështje për nenin 108 të Kodit Penal

- 4 çështje për nenin 130 të Kodit Penal
- 4 çështje për nenin 134 të Kodit Penal
- 2 çështje për nenin 199 të Kodit Penal
- 3 çështje për nenin 236 të Kodit Penal
- 4 çështje për nenin 279 të Kodit Penal
- 8 çështje për nenin 283 të Kodit Penal
- 6 çështje për nenin 284 të Kodit Penal
- 6 çështje për nenin 291 të Kodit Penal
- 11 çështje të tjera

3.6 Në 465 raste të apeli meve për masat e sigurimit Prokurori i Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka kërkuar ndryshimin e vendimit si vijon:

- Në **162** raste Prokurori i Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit sipas ankimit të paraqitur nga Prokurori i Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, nga të cilat për **58** raste Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm e ka pranuar si të drejtë këtë kërkesë dhe për pjesën e mbetur prej **108** kërkesave nuk i ka pranuar duke vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Në **303** raste Prokurori i Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, dhe caktimin e një mase siguri më të butë, duke mbështetur kërkesat e personave nën hetim/pandehur, kërkesa të cilat janë përkrahur dhe gjetur të drejta nga ana e Gjykatës në **299** raste.

TABELA QË PASQYRON KËRKESAT E PROKURORIT TË APELIT PËR NDRYSHIM TË VENDIMEVE TË SHKALLËS SË PARË PËR CAKTIMIN E MASAVE TË SIGURIMIT

Rrethi	Totali i kërkesave të Prokurorit të Apelit për ndryshim vendimi të Shkallës së Parë	Mbështetur Ankimi I Prokurorit të Shkallës së Parë	Kërkesa për masa më të buta	Vendimi i Gjykatës		
				Pranim kërkesë sipas ankimit të Prokurorit	Ndryshim vendimi dhe caktimi i masave të tjera të buta	Miratim vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë
Berat	18	5	13	1	13	4
Dibër	7	3	4	2	4	1
Durrës	36	9	27	3	27	6
Elbasan	26	7	19	4	19	3

Fier	32	15	17	4	17	11
Gjirokastrë	18	10	8	7	10	1
Kavajë	-	-	-	-	-	-
Korçë	18	7	11	4	11	3
Krujë	10	4	6	1	6	3
Kukës	6	4	2		2	4
Kurbin	1	1	-	1	-	-
Lezhë	17	9	8	4	8	5
Mat	3	1	2	1	2	-
Lushnje	-	-	-	-	-	-
Përmet	-	-	-	-	-	-
Pogradec	1	1	-	-	-	1
Pukë	2	2			1	1
Sarandë	16	14	2	4	1	11
Shkodër	8	6	2	1	2	5
Tropojë	1	1		1	-	-
Vlorë	48	29	19	11	18	19
Tiranë	197	34	163	9	158	30
Totali	465	162	303	58	299	108

3.7 Në 1904 raste kryesisht për ankime të të hetuarve, **prokurori** ka kërkuar **miratimin e vendimit** të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.

- Për këtë kërkim të Prokurorit të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, **Gjykata** e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka **vendosur** :
- Në **1613** raste ka **miratimin e vendimit** të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm,
- Në **289** raste ka caktuar masa sigurimi më të **buta** nga vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm,
- Në **11** raste ka **shfuqizuar** vendimin të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke rrëzuar kërkesën për caktimin e masës.

Për çështjet që lidhen me **masat e sigurimit**, Prokurorët e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, kanë ushtruar të drejtën e **rekursit** në Gjykatën e Lartë në **61** raste.

Rrethi	Kërkesa e Prokurorit të Apelit për miratim vendimi	Vendimi i Gjykatës			Rekurse
		Miratim vendimi	Nd.Vendimi masa me te buta	Shfuqizim vendimi	

	të Gjykatës së Shkallë së Parë				
Berat	62	56	6	-	3
Dibër	35	30	5	-	
Durrës	140	114	25	1	4
Elbasan	121	101	20		4
Fier	121	107	13	1	3
Gjirokastrë	72	57	13	2	1
Kavajë	19	15	3	1	
Korçë	157	133	24	-	4
Krujë	27	27	-	-	2
Kukës	32	28	4	-	1
Kurbin	7	7	-	-	
Lezhë	76	69	7	-	4
Mat	6	5	-	1	
Lushnjë	12	9	3	-	
Përmet	5	4	1	-	
Pogradec	16	15	1	-	
Pukë	4	4	-	-	
Sarandë	53	45	8	-	1
Shkodër	73	66	7	-	
Tropojë	3	3		-	
Vlorë	133	118	15	-	9
Tiranë	730	600	125	5	25
Totali	1904	1613	280	11	61

3.8 Nga çështjet e gjykuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me objekt masa sigurimi, numrin me të lartë të veprave penale po e paraqesim si më poshtë vijon:

Për *gjkimet masë sigurimi*, që i përkasin veprave penale “Dhunës në familje”, nenet 130; 130/a; 130/a/1, 130/a/1/2; 130/a/2/3; 130/a/3; 130/a/4 të K.Penal, të përfundura për periudhën Janar- Dhjetor 2023, janë 230 çështje gjithsej.

Për *gjkimet masë sigurimi*, që i përkasin veprave penale penale “Vrasja” nenet 76,76-22,78, 78/1/25 78/2-22, 79/c, 79/dh-25 të K.Penal të përfundura për periudhën Janar-Dhjetor 2023, janë 26 çështje gjithsej.

Për grykimet masë sigurimi, që i përkasin veprave penale në fushën e “Lëndëve narkotike” nenet 283; 283/1; 283/2; 284; 284/1; 284/2; 284/d/2; 285; të K.Penal, të përfundura për periudhën Janar- Dhjetor 2023, janë 281 çështje gjithsej.

Për grykimet masë sigurimi, që i përkasin veprave penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve shpërthyes dhe municionit ”nenet 278; 278/1; 278/2; 278/3; 278/4; 278/5; të K.Penal të përfundura për periudhën Janar- Dhjetor 2023, janë 92 çështje gjithsej.

Për grykimet masë sigurimi, që i përkasin veprave penale penale “Vjedhja” nenet 134;134/1;135/-25/137/1;139;140;141/a-25, 143; të K.Penal të përfundura për periudhën Janar- Dhjetor 2023, janë 150 çështje gjithsej.

4. TË DHËNAT MBI NGARKESËN E PUNËS PËR ÇDO PROKUROR PËR MASAT E SIGURIMIT

Gjatë vitit 2023 ngarkesa e punës për çdo prokuror ka qenë në nivele më të larta se viti i kaluar, çka është e kuptueshme me ndryshimin e hartës gjyqësore.

Ndërkohë ngarkesa midis prokurorëve është në nivele të përafërta, çka është tregues i një organizimi të mirë të brendshëm të punës dhe që përbën përmbushje të detyrimit ligjor për ndarjen e barabartë të punës në Prokurori.

Të dhënat mbi ngarkesën e punës për çdo prokuror, ku përfshihet edhe përfundimi i çështjeve të mbartura nga viti 2022, në përfaqësimin e çështjeve të ndryshme në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2023, paraqiten si në vijim.

4.1 PËR MASA SIGURIMI

Nr	Prokurori	Masa	Shuarje mase	Total Masa	Të ardhura me ankim te prokurorit	Mbeshtetur ankimi prokurorit të Shkallës së Parë	Hequr dore nga ankimi	Pranuar nga Gjykata ankime te prokurorit	Rekurse
1	Arben Qosja	188	45	233	21	13	8	4	7
2	Arta Marku	189	31	220	24	14	10	4	6

3	Aferdita Ndoi	187	30	217	24	16	8	6	7
4	Etien Kapo	204	36	240	19	14	5	5	-
5	Genti Xholi	199	46	245	30	18	12	7	3
6	Gjon Fusha	150	23	173	19	15	4	5	7
7	Irma Balli	152	24	176	13	9	4	2	4
8	Kujtim Bashaj	115	20	135	17	12	5	4	6
9	Kleanth Zeka	210	28	238	20	16	4	8	7
10	Lazer Çardaku	178	27	205	14	11	3	4	7
11	Moisi Duda	168	20	188	22	18	4	6	4
12	Pranvera Gruda	90	10	100	9	6	3	3	3
	Totali	2030	340	2370	232	162	70	58	61

Sipas veprave penale me numrim më të lartë të çështjeve “**Masa sigurimi**”, të gjykuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, po paraqesim të dhënat si më poshtë vijon:

- 1- “**Dhuna në familje**”, **nenet 130; 130/a; 130/a/1, 130/a/1/2; 130/a/2/3; 130/a/3; 130/a/4 të K.Penal**, të përfundura për periudhën Janar- Dhjetor 2023, janë **230** çështje gjithsej.
- **17** çështje ardhur me ankim të prokurorit të shkallës së parë, (**17 çështje kundër vendimit që zbut masen e sigurimit të kërkuar**), nga të cilat :
 - ❖ **13** çështje **mbështetur ankimi** i prokurorit të shkallës së parë nga prokurori i apelit
 - ❖ **4** çështje hequr dorë nga ankimi i prokurorit të shkallës së parë.
- Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për masat e sigurimit të ardhura mbi bazën e ankimit të organit të akuzës, sic shpjeguar më lart, ka pranuar ankimi për 8 çështje.

➤ **213** çështje ardhur me ankim të personave nën hetim nga të cilat, :

- **213** çështje ardhur me ankim të personave nën hetim nga të cilat për **213** çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për **miratim të vendimit**, nga të cilat,
- Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm **ka vendosur:**
 - a) Miratim Vendimi - 183 çështje
 - b) Ndryshim vendimi, masa më të buta - 30 çështje

🚦 Për këtë vepër penale prokurorët e apelit kanë ushtruar **Rekurs** pranë Gjykatës së Lartë në **4** raste

2- “Vrasja” nenet 76, 76-22, 78, 78/1/25 78/2-22, 79/c, 79/dh-25 të K.Penal të përfundura për periudhën Janar- Dhjetor 2023, janë **26** çështje gjithsej.

➤ **3** çështje ardhur me ankim të prokurorit të shkallës së parë *kundër vendimit që zbut masen e sigurimit të kërkuar*), nga të cilat nga ana e prokurorit të apelit :

- ❖ Në 2 çështje është mbështetur ankimi i prokurorit të shkallës së parë nga prokurori i apelit
- ❖ Në 1 çështje hequr dorë nga ankimi i prokurorit të shkallës së parë.

- Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për këtë kërkim ka vendosur:
 - a) Me arrest ne burg, sipas apelimit të prokurorit -2 çështje
 - b) Me masa të tjera me të buta - 1 çështje

- **23** çështje ardhur me ankim të personave nën hetim, ku për të **23** çështjet kërkesa e prokurorit të apelit ka qënë për **miratim të vendimit**.
- **Nga ana e Gjyayës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për këto raste është vendosur:**
 - a) Miratim Vendimi - 22 çështje
 - b) Ndryshim vendimi, masa më të buta - 1 çështje

3- “Lëndët narkotike” nenet 283; 283/1; 283/2; 284; 284/1; 284/2; 284/d/2; 285; të K.Penal, te përfundura për periudhën Janar- Dhjetor 2023, janë **281** çështje gjithsej.

➤ **32** çështje ardhur me ankim të prokurorit të shkallës së parë, (**24** çështje kundër vendimit të gjykatës që ka dhënë një masë sigurimi më të butë nga ajo e kërkuar nga ana e prokurorit dhe **8** çështje kundër vendimit që zëvendëson masen e sigurimit), nga të cilat nga ana e prokurorit të apelit :

- ❖ 21 çështje **mbështëtur ankimi** i prokurorit të shkallës së parë nga prokurori i apelit
- ❖ 11 çështje hequr dorë nga ankimi i prokurorit të shkallës së parë.

- Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për këtë kërkim ka vendosur:
 - a) Me arrest ne burg, sipas apelimit të prokurorit - 9 çështje
 - b) Në 12 raste të rastet e tjera nuk është vlerësuar I drejtë ankimi I organit të akuzës.

- 249 çështje ardhur me ankim të personave nën hetim nga të cilat:
Për këto çështje, nga ana e prokurorit për 233 çështje është kërkuar miratimi i **vendimit dhe në** në 16 raste është kërkuar ndryshimi i vendimit dhe caktimin e një mase më të butë. Duhet theksuar se për 16 rastet që prokurorët kanë kërkuar masa më të buta, kjo kërkesë është gjetur e drejtë nga ana e gjykatës.

Më kokkretisht, për rastet lartpërkshkruar, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm **ka vendosur:**

- a) Miratim Vendimi - 202 çështje
- b) Ndryshim vendimi, masa më të buta - 42 çështje

- 🚦 Për këtë vepër penale prokurorët e apelit kanë ushtruar **Rekurs** pranë Gjykatës së Lartë në 4 raste

4- “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve shpërthyes dhe municionit “nenet 278; 278/1; 278/2; 278/3; 278/4; 278/5; të K.Penal të përfundura për periudhën Janar-Dhjetor 2023, janë 92 çështje gjithsej.

- 8 çështje ardhur me ankim të prokurorit të shkallës së parë, (7 çështje kundër vendimit të gjykatës që ka dhënë një masë sigurimi më të butë nga ajo e kërkuar nga ana e prokurorit dhe 1 çështje kundër vendimit që zëvendëson masen e sigurimit), nga të cilat :

- ❖ 4 çështje **mbështëtur ankimi** i prokurorit të shkallës së parë nga prokurori i apelit
- ❖ 4 çështje hequr dorë nga ankimi i prokurorit të shkallës së parë.

- Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për këtë kërkim ka vendosur:
 - o Me arrest ne burg, sipas apelimit të prokurorit vetëm për një çështje
 - o Në 3 raste të rastet e tjera nuk është vlerësuar I drejtë ankimi I organit të akuzës

- 84 çështje ardhur me ankim të personave nën hetim nga të cilat:

Për këto çështje, nga ana e prokurorit për **79** çështje është kërkuar miratimi i **vendimit dhe në** në 5 raste është kërkuar ndryshimi i vendimit dhe caktimin e një mase më të butë. Duhet theksuar se për 5 rastet që prokurorët kanë kërkuar masa më të buta, kjo kërkesë është gjetur e drejtë nga ana e gjykatës.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm **ka vendosur:**

- a) Miratim Vendimi - 72 çështje
- b) Ndryshim vendimi, masa më të buta - 12 çështje

✚ Për këtë vepër penale prokurorët e apelit kanë ushtruar **Rekurs** pranë Gjykatës së Lartë në 3 raste.

5- **“Vjedhja” nenet 134;134/1;135/-25/137/1;139;140;141/a-25, 143;** të K.Penal të përfundura për periudhën Janar- Dhjetor 2023, janë **150** çështje gjithsej.

➤ **16** çështje ardhur me ankim të prokurorit të shkallës së parë, (**13** çështje kundër vendimit të gjykatës që ka dhënë një masë sigurimi më të butë nga ajo e kërkuar nga ana e prokurorit dhe, **3** çështje kundër vendimit që zëvendëson masen e sigurimit), nga të cilat :

- ❖ **10** çështje **mbështetur ankimi** i prokurorit të shkallës së parë nga prokurori i apelit
- ❖ **6** çështje hequr dorë nga ankimi i prokurorit të shkallës së parë.

- Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për këtë kërkim ka mbështetur organin e akuzës vetëm për 4 çështje.

- **134** çështje ardhur me ankim të personave nën hetim nga të cilat:

- **127** çështje kërkesa e prokurorit të apelit është për **Miratim të vendimit dhe 8 raste për lehtësimin pozite**, nga të cilat, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm **ka vendosur:**

- a) Miratim Vendimi - 107 çështje
- b) Ndryshim vendimi, masa më të buta - 26 çështje
- c) Shfuqizuar Vendimi - 1 çështje

- **1** çështje kërkesa e prokurorit të apelit për **Shfuqizim të vendimin**, kërkesë e pranuar edhe nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

✚ Për këtë vepër penale prokurorët e apelit kanë ushtruar **Rekurs** pranë Gjykatës së Lartë në 4 raste.

Në lidhje me masat e sigurimit, vazhdon të konstatohet që nga ana e organit të akuzës së shkallës së parë, vazhdon masivisht të përzgjidhet masa e sigurimit arrest në burg për të mundësuar hetimet paraprake.

Duhet theksuar se kjo vijë sjellje nuk është vetëm e organit të akuzës por dhe është gjetur e drejtë dhe nga gjykata, referuar statistikës.

Konkretisht nga ky numër i çështjeve të përfaqësuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për **232** prej tyre **apelues** kanë qenë **Prokuroritë** e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kurse për pjesën tjetër **2138**, apelues kanë qenë personat nën hetim. Pra në 2138 raste edhe vetë gjykata e ka pranuar këtë vijë sjellje të organit të akuzës, duke e gjetur të drejtë.

Në qëndrimin e prokurorëve të apelit për këtë kategori, pra masat e sigurimit, tashmë është mbajtur parasysh dhe vendimarrja e Gjykatës së Lartë, Nr.332 datë 15.12.2002 që ka përcaktuar se ***“Prokurori i apelit nuk mund të ndryshojë linjën e qëndrimit të prokurorit të shkallës së parë, prokurorit që është prokuror i hetimit paraprak dhe është ai që ka ndjekur hetimin e çështjes dhe njeh nevojat e sigurimit të çështjes. Nëse ai e bën një gjë të tillë, mendimi i tij nuk është detyrues dhe as kushtëzon vendimarrjen e Gjykatës së Apelit.”***

Këkresat tona për ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, janë bërë kur është konstatuar një diskordacë e theksuar mes rëndëisë së faktit dhe rrezikshmëisë shoqërore të veprës penale dhe autorit të saj, me vendimarrjen e gjykatës.

5. Mbi Rezolutën e Kuvendit dhe Plan Veprimin në zbatim të tij.

Për efekt zbatimi të rezolutës së Kuvendit dhe plan veprimit për vitin 2023, është nxjerrë udhëzimi i përgjithshëm nr. 02 datë 31.07.2023 për zbatimin e Urdhërit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr.103 dt. 25.07.2023 **“Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2023 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2022”**

Plani i veprimit për Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dhe Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 është hartuar mbi disa shtylla me drejtimet si më poshtë përshkruar;

- **Konsolidimi i pavarësisë institucionale dhe funksionale të institucionit të Prokurorisë dhe vecanërisht pavarësinë e prokurorëve në procesin e vendimarrjes.**
- **Përgjegjshmëria dhe llogaridhënia në funksion të rezultateve më të mira në luftën kundër krimit.**
- **Rritja e cilësisë së përfaqësimit të organit të akuzës në veprat penale të dhunës në familje dhe vepra penale ndaj të miturve, krijimi i statistikave dhe raportimi periodik i të dhënave statistikore.**

- Mbrojtja e viktimave të veprës penale të dhunës në familje dhe veprave penale ndaj të miturve.
- Përmirsimi më tej dhe eficient në bashkëpunim dhe koordinimin ndërinstitutional me institucionet dhe agjensitë ligjzbatuese palë në marrveshje dy ose më shumë palëshe, marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja nëpërmjet Zyrës së Prokurorit Ndërlidhës në Eurojust.
- Hetimet financiare për veprat penale të pastrimit të parave dhe produkteve të veprës penale.
- Rritja e kapaciteteve institucionale dhe profesionale në organin e akuzës në zbatim të Konventës KE-së për krimin kibernetik, me qëllim rritjen e efikasitetit në luftën kundër krimit kibernetik dhe mashtrimit në internet.
- Ashpërsimi i politikave penale për veprat penale në fushën e lartpëmendur lidhur me masat e sigurimit personal dhe dënimin e tyre;
- Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në lidhje me arritjen e standardeve të unifikuara në zbatimin e ligjit gjatë ushtrimit të funksionit, veçanërisht zbatimin e udhëzimeve me karakter të përgjithshëm për respektimin e garancive procedurale në procesin penal, si dhe për shkelje individuale të magjistratëve dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Mbi kërkesat e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për secilën prej tyre janë përcaktuar rekomandimet, masat, afatet, strukturat përgjegjëse dhe treguesit e zbatimit.

5.1 Konsolidimi i pavarësisë institucionale dhe funksionale të institucionit të Prokurorisë dhe vecanërisht pavarësinë e prokurorëve në procesin e vendimarrjes. Përgjegjshmëria dhe llogaridhënia në funksion të rezultateve më të mira në luftën kundër krimit.

Për këtë qëllim, është miratuar Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 02 datë 31.07.2023, ku ndër të tjera vihet përsëri theksi tek respektimi i Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr.10/2020 dhe Nr.11/2020 dhe të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë” mbi rregullimin e marrëdhënieve mes Prokurorëve dhe Drejtuesve të Prokurorisë, mbi informimin, transparencën, dhe garantimin e pavarësisë, si në lidhje me qëndrimin e prokurorit për masat e sigurimit ashtu dhe me ceshtjet e themelit, për veprat penale prioritare të rekomanduara sipas ligjit dhe në kuadrin e forcimit të mekanizmit të kontrollit dhe llogaridhënies, duke garantuar paanshmërinë dhe shmangien e çdo lloj influence apo ndikimi ndaj prokurorit gjatë gjykimeve në drejtimet prioritare të rekomanduara në zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2023.

Në këtë aspekt, rëndësi ka marrë respektimi i procesit të shortimit të dosjeve, duke patur në konsideratë një shpërndarje të drejtë jo vetëm në numër por dhe në vepra penale, element ky që është respektuar nga ana e drejtuesit të prokurorisë.

Gjithashtu, për shkak të krijimit të një Gjykate në rang Republike, rëndësi në këtë aspekt, ka diskutimi i vazhdueshëm mes prokuroëve për të mundësuar qëndrime të njëjta, për çështje, të njëjta, aq sa është e mundur pa cënuar pavarësinë e vendimarrjes së prokurorit, me qëllim dhe një unifikim praktike.

5.2 Rritja e cilësisë së përfaqësimit të organit të akuzës në veprat penale të dhunës në familje dhe vepra penale ndaj të miturve, krijimi i statistikave dhe raportimi periodik i të dhënave statistikore.

Për këtë qëllim është miratuar Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 02 datë 31.07.2023, ku ndër të tjera vihet përsëri theksi tek drejtimet prioritare të rekomanduara në zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2023, si më poshtë vijon ;

- **Rritja e cilësisë së akteve dhe përfaqësimit në gjykim të çështjeve penale të regjistruara për vepra penale në fushën e dhunës në familje dhe ndaj të miturve.**
- **Ashpërsimi i masave të sigurimit personal dhe të masave të dënimit për këto vepra.**
- **Pjesëmarrje aktive në trajnimet që zhvillohen nga Shkolla e Magjistraturës, dhe të tjera të organizuara si nga institucione e organizata kombëtare/ndërkombëtare apo dhe trajnime të përbashkëta me fokus në luftën kundër dhunës në familje dhe veprave penale ndaj të miturve.**
- **Të trajtuarit me kujdes të veçantë në përpilimin e treguesve statistikorë periodik për veprat penale të dhunës në familje dhe ndaj të miturve.**
- **Mbrojtja e viktimave të veprës penale të dhunës në familje dhe veprave penale ndaj të miturve.**

Për këtë qëllim, është miratuar Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 02 datë 31.07.2023, ku ndër të tjera vihet përsëri theksi tek drejtimet prioritare të rekomanduara në zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2022, ku i është vënë theksi kujdesit të veçantë nga ana e prokurorëve në komunikimin dhe mbështjen e viktimave të veprës penale të veprës penale të dhunës në familje dhe ndaj të miturve si dhe të trajtuarit me kujdes të veçantë në përpilimin e treguesve statistikorë periodik për identifikimin e viktimave të veprës penale të dhunës në familje dhe ndaj të miturve.

5.3 Përmirësimi më tej dhe eficient në bashkëpunim dhe koordinimin ndërinstitucional me institucionet dhe agjensitë ligjzbatuese palë në marrvshje dy ose më shumë palëshe, mardhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja nëpërmjet Zyrës së Prokurorit Ndërlidhës në Eurojust.

Në këtë aspekt, duhet theksuar një përfaqësim cilësor dhe ndjekja me prioritet e çështjeve penale në fushën e njohjeve të vendimeve penale të huaja dhe ekstradimeve dhe rasteve të tjera ku kërkohet ndihma e ndërsjelltë juridike ndërkombëtare, ku rezultatet kanë qënë

pozitive, pasqyruar kjo dhe në vendmarrjet e Gjykatës në mbështetje të kërkesave tona në këtë fushë.

Këtu i është vënë theksi dhe komunikimit të vendimeve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për të tilla raste, në kohë autoriteteve përkatëse, si dhe rritja e bashkëpunimit me Prokurorin Ndërlidhës në Eurojust me qëllim administrimin në kohë të akteve të kërkuara dhe përfundimit të suksesshëm të këtyre çështjeve.

5.4 Hetimet financiare për veprat penale të pastrimit të parave dhe produkteve të veprës penale.

Për këtë qëllim janë marrë masa për identifikimin e rasteve dhe ashpërsimin e politikës penale për të tilla çështje, duke patur vëmendje të veçantë jo vetëm në mbështetjen e ankimeve të Prokurorëve të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm për rastet të tilla, por sidomos duke treguar një kujdes të veçantë me përfaqësimin në gjykim dhe cilësinë e konkluzioneve.

5.5 Rritja e kapaciteteve institucionale dhe profesionale në organin e akuzës në zbatim të Konventës KE-së për krimin kibernetik, me qëllim rritjen e efikasitetit në luftën kundër krimit kibernetik dhe mashtrimit në internet.

Është patur në konsideratë ashpërsimi i politikave penale për veprat penale në fushën e lartpërmendur lidhur me masat e sigurimit personal dhe dënimin e tyre;

5.6 Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në lidhje me arritjen e standardeve të unifikuara në zbatimin e ligjit gjatë ushtrimit të funksionit, veçanërisht zbatimin e udhëzimeve me karakter të përgjithshëm për respektimin e garancive procedurale në procesin penal, si dhe për shkelje individuale të magistratëve dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

5.7 Në kuadrin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të personit, prokurorët e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kanë treguar një vëmendje të shtuar tek afatet e shuarjes së masave të sigurimit për shkak të mbarimit të dënimit, si dhe afatet e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

6. Zbatimi i Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm mbi rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave.

Bazuar në Urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm "Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e "Rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023" dhe udhëzimit nr.02, datë 12.05.2023 të Prokurorit të Përgjithshëm nxjerrë mbi vendimin e Këshillit të Ministrave nr.226, datë 13.04.2023 "Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023", në zbatim të nenit 10 të aktit lartpërmendur, Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit

të Përgjithshëm Tiranë ka nxjerrë aktin administrativ për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm e konkretisht :

Urdhëzimin e Përgjithshëm Nr. 01 datë 22.05.2023 “Për zbatimin e Udhëzimit nr.02, datë 12.05.2023 të Prokurorit të Përgjithshëm nxjerrë mbi vendimin e Këshillit të Ministrave nr.226, datë 13.04.2023 “Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 ”.

Në këtë udhëzim janë përcaktuar masat administrative dhe procedurale, që duhet të merren për realizimin e përparësive me qëllim sigurimin e zbatimit të rekomandimeve prioritare sipas fushës së kompetencës së Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke synuar një mënyrë vlerësimi të ndjekjes penale që çon në rritje të efikasitetit të luftës kundër kriminalitetit.

Gjithashtu ky udhëzim ka përcaktuar dhe mënyrat dhe format e komunikimit të prokurorëve me Drejtuesin e Prokurorisë si në aspektin e monitorimit të punës ashtu dhe të problematikave që do të dilnin gjatë gjykimit të çështjeve nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

6.1 Masat Administrative në lidhje me aktet e Prokurorit të Përgjithshëm ;

e më konkretisht Urdhërit “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e “Rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2022” dhe Udhëzimit nr.02, datë 12.05.2023 të Prokurorit të Përgjithshëm nxjerrë mbi vendimin e Këshillit të Ministrave nr.226, datë 13.04.2023 “Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 ”, nga ana e Drejtuesit këto akte janë shpërndarë për njohje dhe vlerësim stafit të prokurorëve të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhe në mbledhjen e prokurorëve janë miratuar masat administrative për zbatimin e rekomandimeve prioritare.

Këto akte janë bërë të njohura dhe stafit mbështetës të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

6.2 Në lidhje me Informimin në Prokurorinë e Përgjithshme ;

Gjatë periudhës kohore pas daljes së akteve lartpërmendur, nga ana e Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë janë dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme informacionet përkatëse analitike dhe të detajuara të veprimtarisë së Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për periudhat 3, 6, 9 dhe 12 mujore.

Krahas sa më lart, është dërguar informacion në të cilën janë pasqyruar të dhëna të hollësishme dhe analitike, të dhëna që përbëjnë dhe prioritete të përbashkëta mes Rezolutës së Kuvendit dhe Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023.

6.3 Forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut.

Janë përcaktuar dy aspekte që lidhen me nxitjen e aplikimit të dënimeve alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet e të miturve, personave vulnerabël dhe personave me probleme shëndetësore. Ndërkohë që është vijuar me ashpërsimin e masave të sigurimit dhe masës së dënimit për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe në rastet e keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit e trafikimit të fëmijëve.

Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar disa çështje penale ku në rastet e veprave penale dhe autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet e të pandehurve të mitur, janë aplikuar dënimet alternative. Për të miturit vëmendje e veçantë u janë kushtuar dispozitave ligjore të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar disa çështje penale për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese. Për këto çështje penale qëndrimet e mbajtura nga prokurorët e apelit lidhur me masat e sigurimit dhe masat e dënimit kanë qenë ashpërsuese, duke iu përgjigjur rrezikshmërisë së veprave dhe autorëve të tyre. Në rastet kur çështjet kanë ardhur në apel me ankimin e të pandehurve/personave nën hetim, qëndrimi i mbajtur nga Prokurorët e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm pothuajse në të gjitha rastet ka qenë lënia në fuqi ose miratimi i vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, dhe në rastet kur çështja në Apel ka ardhur mbi ankimin e Prokurorit të Shkallës së Parë, ankimet përgjithësisht janë mbështetur nga Prokurorët e Apelit.

Në lidhje me verifikimin sistematik të ecurisë dhe përfundimit të çështjeve në gjykim për veprat penale prioritare të rekomanduara, janë monitoruar në veçanti, afatet proceduriale në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kryesisht me afatet e paraburgimit.

Në këtë aspekt, duke patur në konsideratë faktin se në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka një numër shumë të konsiderueshëm dosjesh penale që presin për gjykim, krahasuar kjo me një numër të vogël trupash gjykimi, ka bërë që t'i jepet prioritet gjykimeve penale me persona të cilët janë me masën e sigurimit "arrest në burg" dhe ato që kanë të bëjnë me ekstradimet dhe njohjet e vendimeve penale të huaja.

Pra në këtë situatë, dhe çështjet që dalin për shqyrtim, janë të kushtëzuara nga masa e sigurimit, faktor që nga ana tjetër ndikon në respektimin e afateve të gjykitimit të çështjeve me të paraburgosur dhe sjell si pasojë dhe një respektim të të drejtave të tyre proceduriale për një gjykim të shpejtë.

6.4 Përfaqësimin e akuzës gjatë gjykitimit në Apel dhe respektimin e afateve ligjore,

Gjatë vitit 2023, nga Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, janë respektuar me korrektesë detyrimet e ligjit procedural penal, si dhe urdhërat dhe

udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, për respektimin e afateve në shqyrtimin e çështjeve të ankimuara.

Sa më sipër kryesisht, por jo vetëm, për :

- prezencën e prokurorëve në të gjitha seancat gjyqësore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si për çështjet e themelit, për masat e sigurimit apo ankimet e veçanta dhe kërkesa të tjera penale, duke respektuar solemnitetin dhe etikën në gjykim,
- për nxjerrjen në kohë të urdhërave të ekzekutimit në zbatim të vendimeve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- Dërgimin e vendimeve penale në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore kompetente,
- Ushtrimin brenda afateve ligjore të së drejtës së rekursit në Gjykatën e Lartë.

Gjithashtu nuk ka patur asnjë rast gjatë vitit 2023 që ndaj prokurorëve, apo punonjësve të tjerë të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të jetë inicuar procedimi disiplinor apo të jenë marrë masa disiplinore nga organet kompetente sipas ligjit, për shkaqet e përmendura më sipër.

6.5 Rekursët

Në rastet e parashikuara nga ligji dhe kur vendimet e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm kanë qenë të ndryshme nga kërkimet e akuzës, është ushtruar recurs në Gjykatën e Lartë për çështjet respektive, gjithnjë duke patur në konsideratë se tashmë, Gjykata e Lartë pranon për shqyrtim çështje vetëm kur konstaton shkelje të parashikimeve të nenit 432 i Kodit të Procedurës Penale.

Kjo dispozitë, në pikën 1 të tij, parashikon se recursi kundër vendimit të Gjykatës së Apelit mund të bëhet kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji procedural me pasoje pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Sidoqoftë ushtrimi i kësaj të drejte mbetet tërësisht diskrecion i prokurorit të çështjes, dhe vlerësimit që ai i bën vendimarrjes së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me qëllim identifikimin e kushteve për të ushtruar recurs.

Në kuadër dhe të ndryshimeve që pësoi Kodi i Procedurës Penale, kanë funksionuar dy urdhërat që normojnë administrimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, (pra momenti i depozitimit të tyre në formë të plotë dhe të arsyetuar) si dhe rekursve të paraqitura nga palët në proces.

Për këtë qëllim, në zbatim të urdhërimeve lartpërshtuar, kanë funksionuar normalisht dy regjistrat e posaçëm, ku në njërin pasqyrohet saktësisht data e depozitimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me

qëllim përlllogaritjen e saktë të afatit të rekursit dhe në tjetrin, momenti i depozitimit të rekursit të palëve, me qëllim realizimin e kundër rekursit kur shihet e novojshe nga ana e prokurorëve.

Duhet theksuar, se konstatojmë se një pjesë e konsiderueshme e rekurseve të përpiluara nga ana e Prokurorëve të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë gjetur të drejtë nga ana e Gjykatës së Lartë, duke pasqyruar dhe një unifikim praktike vendimarrëse të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

6.6 Lidhur me bashkëpunimin me institucionet e tjera, gjatë vitit 2023 kanë vijuar raportet korrekte me institucione të tjera, në zbatim të ligjit procedural dhe atij organik për Prokurorinë.

Në keto marrëdhënie rolin kryesor e zënë ato që lidhen me;

- Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për fazën që lidhet me përfaqësimin e akuzës në gjykimin e çështjeve të ankimuara, si dhe të detyrimeve të përbashkëta administrative për mbarëvajtjen e punës.
- Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, që veprojnë në juridiksionin e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për bashkëveprimin në funksion të përfaqësimit sa më të mirë të akuzës në çështjet e ankimuara, veprimtarisë në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale dhe detyrimeve të tjera ligjore të prokurorit.
- Strukturat e Policisë së Shtetit dhe institucionet e tjera që përfshijnë shërbime të Policisë Gjyqësore, për zbatimin e urdhërave për ekzekutimin e vendimeve penale.
- Me Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për fazën e ekzekutimit.
- Me Prokurorinë e Përgjithshme, si institucioni që përfaqëson çështjet e rekursuara, si dhe në bashkëpunimin për çështje të tjera të natyrës administrative.
- Me institucionet e tjera, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore.

6.7 Bashkëpunimi me Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Sikurse u përmend edhe më sipër, raportet e kësaj zyre me Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kanë qenë korrekte dhe ligjore, në përfaqësimin e akuzës në gjykimet në Apel dhe plotësimin e detyrimeve të tjera ligjore.

Nga ana e prokurorëve, janë bërë përpjekje maksimale për të mundur pjesëmarrjen e tyre në kohë në gjykim, respektimin e solemnitetit të tij, ruajtjen e sekretit për vendimet që lidhen me akte të asaj natyre të hetimeve paraprake, procedurat për dërgimin në organet kompetente të vendimeve penale me ekzekutim të menjëhershëm etj.

Po ashtu një vëmendje e posaçme i është kushtuar përmbushjes së detyrimeve të përbashkëta ligjore në fushën e administrimit të drejtësisë, transparencën ndaj publikut. Duke e konsideruar të rëndësishëm këtë aspekt, është përcaktuar dhe Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Prokurori i Medias.

6.8 Bashkëpunimi me Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Edhe gjatë vitit 2023 kanë vijuar raportet e bashkëpunimit me të gjitha Prokuroritë e Rretheve të Juridiksionit të Përgjithshëm, për trajtimin e problematikave që hasen në gjykimin e çështjeve të ankimuara, si për qëllime të rritjes së nivelit cilësor të apeliimeve, shkëmbimit të informacioneve për fazën e çështjeve konkrete, dërgimit të njoftimeve për fazën e ekzekutimit të vendimeve penale etj.

Gjatë kësaj periudhe kemi gjetur mirëkuptimin e plotë të drejtuesve dhe prokurorëve të zyrave përkatëse për përmirësimin e problematikave të hasura, si rritjen e nivelit cilësor të apeliimeve, parashtrimit të të gjitha shkaqeve ligjorë në to, ushtrimin e apeliimeve për masat e sigurimit vetëm për rastet e domosdoshme të hetimit paraprak, përmirësimin e komunikimit dhe njoftimit të zyrave respektive për rrethanat e gjykimit.

6.9 Bashkëpunimi me strukturat e Policisë së Shtetit.

Raportet me strukturat e Policisë së Shtetit në Drejtoritë Vendore të Policisë së Qarqeve gjatë vitit 2023 kanë qenë tërësisht korrekte dhe ato janë shtrirë kryesisht në fushën e njoftimit të palëve në fazën e gjykimit dhe shkëmbimit të të dhënave që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimeve penale nga Prokurorët e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, apo në bashkërendimin e veprimeve në funksion të administrimit të drejtësisë.

6.10 Bashkëpunimi me Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Raportet me Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale gjatë vitit 2023, kanë qenë bashkëpunuese dhe korrekte dhe ato janë shtrirë në të gjitha aspektet ku ligji e parashikon këtë bashkëpunim, përfshirë atë të njoftimeve, shkëmbimit të informacioneve të nevojshme për çështjet, në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale dhe në kompetencë të Prokurorëve të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, sikurse janë ato për masat e sigurimit apo udhërimet e tjera të Gjykatës etj.

6.11 Bashkëpunimi me Prokurorinë e Përgjithshme.

Gjatë vitit 2023 ka vijuar raporti i ngushtë i bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme.

Ky bashkëpunim është shtrirë jo vetëm me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Drejtorinë Gjyqësore apo me Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë për shkëmbimin e të dhënave në atë fushë, por edhe me të gjitha drejtoritë dhe sektorët e tjerë të Prokurorisë së Përgjithshme.

Pikërisht edhe në sajë të këtij bashkëpunimi dhe plotësimit të nevojave administrative nga sektorët e tjerë të Prokurorisë së Përgjithshme, është bërë e mundur përballimi i një volumi të konsiderueshëm në punë nga Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sidomos në lidhje me proceset e Njohjeve të Vendimeve Penale të

Huaja, duke mundësuar informimin dhe realizimin në kohë të shqyrtimit gjyqësor të këtyre proceseve, për të cilat ligja procedurale parashikon afate kohore të shkurtra. Edhe gjatë vitit 2023 janë respektuar detyrimet e prokurorëve për të zbatuar në kohë dhe me cilësi urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, lidhur me ushtrimin e funksioneve të Prokurorit në Apel.

7. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË.

Gjatë vitit 2023 edhe personeli administrativ i kësaj zyre, ndonëse i kufizuar numerikisht, e ka kryer me korrektesë detyrën e vet duke qenë mbështetje për prokurorët në përballimin e kësaj ngarkese në punë.

7.1 Nga ana tjetër, vendi vakant për më shumë se katër vjet i Kacelarit të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, vakancë e njohur dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ka sjellë problematikë në mirëfunksionimin e administratës së kësaj prokurorie.

Plotësimi i strukturës, do të sillte efikasitet në ndjekjen e problematikave të natyrës administrative dhe zgjidhjen e tyre, sidomos në kushtet e hartës së re gjyqësore, ku kërkohet një impenjim dhe angazhim qoftë dhe në elementin kohor, për të përmbushur këtë aspekt mjaft të rëndësishëm të organit.

Gjithashtu nisur nga fakti i një stafi të kufizuar të prokurorëve edhe vetë Drejtuesi i Prokurorisë gjatë kësaj periudhe ka marrë ngarkesë të njëjtë me prokurorët, ndërkohë që është dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Emërimeve në Drejtësi, si dhe anëtar i Bordit Drejtues Të Qendrës Së Teknologjisë Së Informacionit Për Sistemin E Drejtësisë, pjestar I Grupit të Ekspertëve Mbështetës për Sistemin e Qëndërzuar të Çështjeve, funksione që kërkojnë një përkushtim në kohë dhe seriozitet për shkak të rëndësisë që kanë.

7.2 Administrata

Gjatë vitit 2023, janë nxjerrë disa urdhëra për mbarëvajtjen sa më të mirë të punës të administratës.

Në vazhdimësi të urdhërit nr.06, date 22.04.2021 për “Ngritjen e Komisionit të Ekspertizës pranë Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ky komision ka vazhduar punën për administrimin e arshivave të ardhura nga ish Prokuroritë e Apelit Durrës, Korçë, Gjirokastrë, Shkodër, Vlorë si pasojë e krijimit të Hartës së Re Gjyqësore.

Pra, jemi përpara një volumi të madh pune të pritshëm që do të realizojë jo vetëm përpunimin e akteve që janë në dorë por edhe atyre të ardhura nga arkivat e sipërpërmendura.

Në të tilla kushte është e pamundur që gjithë ky volum pune të përballohet nga arkivistja e institucionit , dhe për këtë arsye çmojmë se do të ishte shumë e domosdoshme që deri në përfundim të përpunimit të këtyre dokumantave të krijohej mundësia për krijimin e një grupi pune me persona që kanë njohuri mbi arkivat.

Është nxjerrë vendimi nr. 1, datë 03.02.2023 për ngritjen e komisionit të përhershëm të vlerësimit të kandidatëve (për sekretare prane prokurorëve në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë).

Është nxjerrë urdhëri nr.5, datë 03.02.2023 për ngritjen e komisionit për vlerësimin dhe asgjësimin e vulave të kryesekretarisë së ish Prokurorisë të Apelit Gjirokastrë dhe ish Prokurorisë të Apelit Durrës.

Është nxjerrë urdhëri nr.8, datë 06.03.2023 për ngritjen e komisionit për vlerësimin dhe asgjësimin e vulave të kryesekretarisë së ish Prokurorisë të Apelit Tiranë.

7.3 Financa

Gjatë vitit 2023, buxheti financiar i kësaj zyre është administruar me korrektesë dhe rigorozitet, pavarësisht fluksit të madh të punës.

Si pasojë e disiplinës financiare dhe ndihmës gjithëvjetoare nga Prokuroria e Përgjithshme, nga ana jonë buxheti është realizuar thuajse 100% dhe janë likuiduar të gjitha detyrimet ndaj të gjithë subjekteve.

Po ashtu janë mbajtur të gjithë regjistrat financiarë, sipas detyrimeve ligjore dhe udhëzimeve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Financave.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë gjatë vitit 2023 për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike –financiare janë çelur fondet si më poshtë:

Fondet 2023	Plani 2023	Fakti 2023	Realizimi
Fondi i pagave 600	107 887 364	107 782 593	99.9%
Fondi I.Sig.shoq.shënd 601	78 97 588	78 33 972	99.19%
Shpenzime korrente 602	9 213 398	9 002 106	97.71 %
Ndihmë ekonomike 606	459 459	459 459	100 %

Investime 231	90 000	90 000	100 %
---------------	--------	--------	-------

Fondi i pagave është realizuar në masën 99,9 %.

Gjatë vitit 2023 është bërë pagesa e magjistratëve për detyrimet e prapambetura të pagës për vitet 2019, 2020, 2021 dhe për disa magjistrat për vitin 2022.

Në vazhdimësi me çeljen e fondeve nga Prokuroria e Përgjithshme do të bëhet edhe likuidimi i detyrimeve për vitin 2022 të pjesës tjetër që ka mbetur pa u likuiduar.

Rillogaritja e fondit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është bërë sipas ligjeve në fuqi ku sigurimi shoqëror llogaritet 9.5% mbi pagën maksimale në Republikën e Shqipërisë, e cila është 176,416 lekë, kurse sigurimi shëndetësor dhe kontributi suplementar llogariten mbi pagën bruto.

Theksojm se:

Gjatë vitit 2023, kërkojmë t'ju bëjmë me dije si rezultat i mbylljes së Prokurorive të Apeleve të Durrësit, Vlorës, Gjirokastrës, Korçës, Shkodrës, nuk mund të ndërhyjmë në sistemin e tatimeve përkatëse pasi subjektet janë çregjistruar.

Mosdeklarimi i ndryshimit të pagave të magjistratëve sjell probleme në vetëdeklarimin e të ardhurave vjetore dhe tatimit të paguar personal të secilit prej tyre.

Lidhur me realizimin e fondit të shpenzimeve korrente realizimi është 97.71%.

Peshën më të madhe e zë zëri "Shpenzime për ruajtjen e objektit", që përfshin ruajtjen fizike të ndërtesës dhe aseteve të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Fondi i ndihmës ekonomike është realizuar 100 % duke u transferuar tek individët në nevojë.

Gjithashtu fondi i investimeve është realizuar 100%. Ky fond është përdorur për zgjerimin dhe restaurimin e një ambienti për arkivën e institucionit.

Realizimi i fondeve është në masën 99 %.

8. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2024.

Nga analiza në tërësi e treguesve që u përmendën më sipër, për vitin 2024 prioritetet kryesore të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm do të jenë si në vijim :

1. Përfundimi sa më parë i të gjitha çështjeve penale të mbartura në gjykim.

2. Vazhdimi i ndjekjes me përparësi të përfaqësimit të akuzës në çështjet e ankimuara që janë në fokus të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe Planit të Veprimit në zbatim të saj, rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe urdhërave e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, sidomos ato që lidhen me krimet kundër jetës të kryera me dashje, ato në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, kundër rendit e sigurisë publike dhe trafikeve të të gjitha llojeve, veprat penale kundër drejtësisë, ato që çënojnë sistemin demokratik të zgjedhjeve etj.
3. Rritjen e nivelit cilësor të përfaqësimit të akuzës në Apel.
4. Rritjen e nivelit cilësor të rekurseve në Gjykatën e Lartë.
5. Konsolidimi i mëtejshëm i bashkëpunimit shumë të mirë me prokuroritë e Rretheve Gjyqësore të Juridiksionit të Përgjithshëm, me strukturat e Policisë së Shtetit dhe me Prokurorinë e Përgjithshme, pikërisht në funksion të rritjes së cilësisë së përfaqësimit të akuzës në Apel.
6. Respektimi nga prokurorët i detyrimeve të ligjit procedural penal, ligjit organik të Prokurorisë dhe urdhërave e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.
7. Ruajtjen e figurës së pastër të prokurorëve dhe respektimin prej tyre të normave të solemnitetit në gjykim, etikës dhe të sjelljes së denjë në publik.
8. Përmirësim i vazhdueshëm i kushteve të punës;

DREJTUESI I PROKURORISË

Genti XHOLI